



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0887

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Ar Driti” N.T.SH kundër Vendimit vendimit për dhënie të kontratës lidhur me procedurën e prokurimit të Komuna Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i tribunës Flamurtari me numër të prokurimit:616-25-5377-5-2-1, me 13/01/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Ar Driti” N.T.SH me nr. 2025/0887 , e datës 11/09/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Ndërtimi i tribunës Flamurtari me numër të prokurimit: 616-25-5377-5-2-1.
2. Anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit me titull Ndërtimi i tribunës Flamurtari dhe numër të prokurimit 616-25-5377-5-2-1.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Ar Driti” N.T.SH

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 16/06/2025, Komuna Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ndërtimi i tribunës Flamurtari me numër të prokurimit 616-25-5377-5-2-1.

Ndërsa me datën 20/08/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE Age Group SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 142,733.21 €

Me 01/09/2025, OE “Ar Driti” N.T.SH ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11/09/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Ar Driti” N.T.SH me nr. 0887/2025 lidhur me aktivitetin Ndërtimi i tribunës Flamurtari me numër të prokurimit:616-25-5377-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ar Driti” N.T.SH janë parashtruar si në vijim:

Pas njoftimit për dhënien e kontratës, konform ligjit për qasje në dokumente zyrtare, kemi bërë kërkesë pranë Autoritetit Kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës, e cila na ka lejuar qasjen dhe ka qenë shumë korrekt gjatë procedurës.

Pas analizës së detajuar nga ekspertët tanë të prokurimit, kemi gjetur shumë mangësi në vlerësimin e ofertës nga ana e komisionit, pasi nga analiza jonë rezulton që Operator Ekonomik (OE) "AGE GROUP" SHPK është ofertë e papërgjegjshme, konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Sipas kërkesës në dosje, pika 8.1 dhe 8.2:1. Operator ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme për Autoritetin Kontraktues se qarkullimi vjetor i tij gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë jo më pak se 250,000.00 euro (60% bartësi i konzorciumit).2.Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo konfirmimi nga banka për qarkullimin e kërkuar.

OE i shpallur fitues ka dështuar të përmbushë këtë pikë, pasi kërkesa e AK-së ka qenë deklaratat e dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit, ndërsa i mungon viti 2024. Prandaj, konsiderojmë që nuk e ka përmbushur këtë pikë dhe është i papërgjegjshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë.

Në pikën 9.1 dhe 9.2, përsa i përket gjendjes ekonomike-financiare:

- 1.Operator ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme, apo punë ndërtimore në rrugë ose hapësira publike me vlerë minimale prej 200,000.00 euro, në 3 vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) (60% bartësi i konzorciumit).

Gjatë analizës së kontratave të paraqitura në Aneksin 6, kemi këto gjetje:

OE ka paraqitur kontratën e parë: Riparimi i monumenteve kulturore dhe historike, me nr. prokurimit 623-18-7079-521 në vlerë prej 78,846.46 euro, e nënshkruar më 15/11/2018. Referenca për këtë punë, e lëshuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në janar 2023 nga drejtori z. Afrim Dina, konfirmon se punimet janë kryer nga 17.11.2018 deri më 20.11.2020.

Nga kjo shihet qartë se punimet janë përfunduar më 20.11.2020, ndërsa OE "AGE GROUP" në Aneksin 6 ka paraqitur datën 20.01.2023 si përfundim të punimeve, duke falsifikuar datat për të përmbushur kriteret e kërkuara. Ky veprim përbën mashtrim ndaj Komunës së Prishtinës dhe tregon papërgjegjshmëri në përmbushjen e kriteve.

Për kontratat tjera: Ndërtimi i QMF-së në Qifllak, vlera 82,996.59 euro, nënshkruar më 01.08.2019 dhe përfunduar më 20.01.2023. Aneks kontrata për Ndërtimin e QMF-së në Qifllak, vlera 8,105.79 euro, nënshkruar më 01.10.2020 dhe përfunduar më 20.01.2023. Ndërtimi i pllakes përkujtimore "Altari i Lirisë", vlera 13,446.00 euro, nënshkruar më 11.09.2019 dhe përfunduar më 20.01.2023.

Duke parë vlerat e vogla të këtyre kontratave, është e pakuptueshme që realizimi i tyre të zgjasë 3-4 vite. Konstatimi ynë është se OE ka paraqitur datat e përfundimit më vonë për të përmbushur kriteret e kërkuara për qarkullim në tre vitet e fundit. E njëjta vërehet edhe për kontratat nën numrat 5, 6, 7 dhe 8, të cilat janë nënshkruar në vitet 2019-2020 dhe përfunduar në vitet 2023 dhe 2024.

Dyshojmë se të gjitha datat e paraqitura janë ndryshuar qëllimisht për të plotësuar kriteret e tenderit.

Sipas Aneksit 6: Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi i rreme, oferta do të konsiderohet si e papërgjegjshme dhe OE do të dërgohet në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik. Kjo kërkesë është marrë nga dosja e tenderit, prandaj kërkojmë nga ju që të verifikoni të gjitha kontratat e paraqitura gjatë kërkesës për rishikim dhe të veproni sipas procedurave, duke kërkuar nga OSHP vendosjen e këtij OE në listën e zezë. **Sqarim:** Verifikimin e kontratave e kemi kërkuar edhe ne si OE përmes postës elektronike duke iu drejtuar Komunës së Rahovecit. Si rrjedhojë, konsiderojmë se ky OE nuk e përmbush kërkesën e AK për kontrata në vlerë prej 200,000.00 euro dhe është i papërgjegjshëm edhe në këtë pikë.

Pika 2: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi për stafin profesional si më poshtë:

- Një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv) me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia duhet të përfshijë CV, diplomë, kontratë pune me punëdhënësin ose marrëveshje për angazhimin në këtë projekt. Kontrata e lidhur me inxhinierin e ndërtimit dhe OE nuk është në përputhje me Ligjin e Punës, pasi nuk përmban elementet bazike, mungojnë të dhënat personale (data e lindjes), numri personal, autorizimi i nënshkruesit nga pronari i OE dhe nuk figurojnë vlera e kompensimit sipas ligjit. Si pasojë, kjo kontratë nuk përmbush as minimumin ligjor për krijimin e marrëdhënies së punës. Në këtë pikë OE është i papërgjegjshëm.
- Një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës (drejtimi elektroenergjetik) me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Dëshmia përfshin CV, diplomë dhe kontratë pune ose marrëveshje angazhimi.

Po ashtu, kontrata nuk përmban të dhëna personale, autorizim nga pronari, apo vlerën e kompensimit, prandaj nuk përmbush kërkesat ligjore. OE është i papërgjegjshëm edhe në këtë pikë.

- Një inxhinier i diplomuar i arkitekturës ose ndërtimtarisë (konstruktiv) me minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit, me dëshmi CV, diplomë dhe kontratë pune ose marrëveshje. Po ashtu, mungojnë të dhënat personale, autorizimi dhe kompensimi, prandaj kontrata nuk përmbush kërkesat ligjore. OE është i papërgjegjshëm.
- Një ekspert i certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë nga MPMS me minimum 3 vite përvojë pune në këtë fushë.
Për këtë kriter, OE ka paraqitur z. Muhamet Hamiti, i cili plotëson kushtet e parashikuara nga AK - Komuna e Prishtinës.
- Një ekspert i certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri me minimum 3 vite përvojë pune nga IHHB.
Për këtë kriter, OE "AGE GROUP" SHPK ka paraqitur po z. Muhamet Hamiti, i cili posedon certifikatën e AME, por nuk plotëson kushtin si ekspert i veçantë pasi mbulon edhe ekspertin për Siguri dhe Shëndet në Punë. Kërkesa e AK-së është e qartë që për pozitat duhet të jenë dy persona të ndryshëm. Për këtë arsye, OE ka dështuar në plotësimin e kësaj pike.

Sqarim: Sikur kërkesa të ishte për një person të vetëm të certifikuar për Siguri dhe Shëndet në Punë dhe mbrojtje nga zjarri, atëherë do të ishte e pranueshme, por kërkesa është për dy pozita të ndryshme nga dy ekspertë të veçantë.

Kërkesa për:

- Dy saldues të certifikuar, me kopje të certifikatave ose diplomave.
Kontratat e lidhura mes salduesve dhe OE nuk janë në përputhje me Ligjin e Punës sepse mungojnë elementet bazike: të dhëna personale (datat e lindjes), numri personal, autorizimi i nënshkruesit nga pronari, dhe nuk figuron vlera e kompensimit. Këto kontrata nuk përmbushin minimumin ligjor për krijimin e marrëdhënies së punës. OE është i papërgjegjshëm edhe në këtë pikë.
- Kërkesa për angazhimin e 10 (dhjetë) punëtorëve.
Kontratat ose marrëveshjet për angazhimin e punëtorëve nuk janë në përputhje me ndryshimet e fundit në Ligjin e Punës. Analiza e pagave tregon se ato nuk janë të përputhshme me orët e punës dhe normat ligjore, duke qenë si më poshtë:
 - Punëtoreshë Gezime Bala – paga 200.00 euro (40 orë/javë)
 - Punëtori Dashamir Morina – paga 180.00 euro (40 orë/javë)
 - Punëtori Muhamed Hajda – paga 200.00 euro (40 orë/javë)
 - Punëtori Tahir Bala – paga 300.00 euro (40 orë/javë)
 - Punëtori Sefedin Hamza – paga 200.00 euro (40 orë/javë)
 - Punëtori Arlind Rexhepi – paga 200.00 euro (40 orë/javë)
 - Punëtoreshë Diona Bala – paga 200.00 euro (40 orë/javë)
 - Punëtori Edvin Dema – paga 200.00 euro (40 orë/javë)

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 57 të Ligjit Nr. 03/L-212 për Punën, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 gusht 2024, merr këtë:

1. Aprovohet propozimi i Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës në nivelin prej 2.00 € (dy euro) për një orë pune të rregullt, apo 350.00 € (treqind e pesëdhjetë euro) bruto në muaj për punë me orar të plotë.
2. Paga minimale e përcaktuar në pikën 1 fillon së zbatuari nga data 1 tetor 2024.

Në bazë të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-117, asnjë kontratë e punëtorëve të këtij Operator Ekonomik (OE) nuk e përmbush këtë ligj dhe si e tillë konsiderohet jovalide pasi bie ndesh me ligjin. Prandaj, konsiderojmë se edhe në këtë pikë OE është i papërgjegjshëm, pasi për orar të plotë prej 40 orësh në javë ka paraqitur kompensim në vlerë prej 180-200 euro.

3. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet 9, 12, dhe 13.

Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga OE "AGE GROUP SHPK" konstatojmë që OE i shpallur fitues ka paraqitur autorizimin në mënyrë të përgjithshme, pa përmendur pozicionet 9, 12, dhe 13. Si pasojë, nuk ka përmbushur kriterin e kërkuar për autorizim me pozicione të caktuara dhe në këtë pikë është i papërgjegjshëm.

4. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë katalogun nga prodhuesi me specifikat e kërkuara për pozicionet e paramasës (9, 12, 13).

Në bazë të dokumentacionit të ofruar nga OE "AGE GROUP SHPK" konstatojmë se katalogu është paraqitur në mënyrë të përgjithshme, pa përmendur pozicionet 9, 12, dhe 13. Për këtë arsye, nuk ka përmbushur kriterin për autorizim me pozicione të caktuara dhe është i papërgjegjshëm.

5. Një listë të pajisjeve, sipas Aneksit 7, librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen, deklaratat unike doganore ose kontratat, faturat e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim të marrjes me qira.

Nga kjo kërkesë kemi këto gjetje:

Një kamion i pajisur me shportë (platformë ngritëse) me minimum 10 metra lartësi ngritjeje të shportës.

OE "AGE GROUP SHPK" ka dështuar të përmbushë këtë kriter:

- Marrëveshja për huazim mes OE "AGE GROUP SHPK" dhe "SELMANS NETWORK SHPK" është nënshkruar më 24.03.2025 dhe në bazë të numrit të prokurimit shihet se është marrëveshje për një tender tjetër i cili është anuluar dhe ka numër tenderi të ndryshëm. Pra, vjen në përfundim se marrëveshja nuk vlen dhe nuk është për këtë aktivitet të prokurimit.
- Libreza për kamionin me vinç është me afat të skaduar dhe nuk ka validitet, duke mos përmbushur kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Regjistri i kamionit ka datë 15.04.2025.
- Kamioni me korp të prezantuar është nga Franca dhe nuk ka librezat e qarkullimit të Kosovës, që nënkupton se nuk përmbush kriterin për pajisje.

Duke pasur parasysh se marrëveshja me "SELMANS NETWORK SHPK" dhe marrëveshja me Habib Salihun kanë datë 24.03.2025 dhe numër tenderi tjetër, konsiderojmë se OE "AGE GROUP SHPK" nuk e ka përmbushur në tërësi kërkesën për pajisje dhe në këtë pikë është i papërgjegjshëm.

Nga të dhënat e prezantuara kërkojmë nga AK-Komuna e Prishtinës që të anulohet vendimin për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Koment: AK-Komuna e Prishtinës ka refuzuar kërkesën për rishikim, duke mos trajtuar asnjë nga pretendimet tona.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues me datë 18/09/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0887/2025, ndërsa me datë 29/09/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0887/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Ar Driti” N.T.SH eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0887ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtine, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndertimi I tribunes Flamurtari”, me numër të prokurimit: 616-25-5377-5-2-1. Procedura e procedurë e hapur, ndërsa lloji i kontratës punë. Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit më datë 16.06.2025.

Më datë 11.09.2025, OE: N.TSH. “Ar-Driti”-Ferizaj, Kosovë, ka paraqitur ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, duke kundërshtuar AK-Komunen e Prishtinës se gjate vlersimit te ofertave ka shkelur keto nene 1, 6, 7, 57, 68 dhe 69 te LPP-se dhe duke kundërshtuar Letrën Standarde për Njoftimin e Eliminimit, me pretendime si në vijim:

Pretendimi nr. 1: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm në pikën 8.1 dhe 8.2 të Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ku nuk ka ofruar qarkullimet nga ATK në tri vitet e fundit”, sipas kriteri të vendosur nga AK në FDT ka kërkuar: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 250,000.00 Euro (60% Bartësi i konzorciumit). 1 Deklaratat e dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo konfirmimin nga banka për qarkullimin e kërkuar

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson kete pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i plotëson dhe i tejkalon kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues në pikat 8.1 dhe 8.2 të Dosjes së Tenderit. Gjithashtu, Formulari i ATK-së per Deklarimin Vjetor per periudhën 2024 gjendet në ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë.

Pretendimi nr. 2: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate eshte I pa pergjegjshem ne piken 9.1 dhe 9.2 te Kapaciteti ekonomik dhe financiar, ku nuk ka ofruar kontrata-referncat qe ka kryer pune te kesaj natyre ne tri vitet e fundit”, sipas kriteri te vendosur nga AK ne FDT ka kerkuar:1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të kësaj natyre, ose punë ndërtimore në rrugë apo në hapësira publike me vlere minimale prej 200.0000,00 € Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).(60% Bartësi i konzorciumit).

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk e ka përmbushur kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në pikat 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit. OE i rekomanduar ka ofruar një listë të kontratave dhe referencave të realizuara gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020, të cilat janë më të vjetra se periudha e kërkuar prej tre (3) viteve të fundit. Përfundim bën vetëm një kontratë-aneks dhe një referencë nga viti 2021. Te gjitha keto kontrata-referenca ka leshuar AK – Komuna e Rahovecit në vitin 2023/2024, kjo është bërë pas kërkesës së Operatorit Ekonomik dhe nuk e ndryshon faktin se periudha e realizimit të punëve është jashtë afatit të kërkuar. Asnjëra nga kontratat dhe referencat e ofruara nuk specifikon qartë datën e fillimit dhe përfundimit të punëve, përveç listës së kontratave ku janë shënuar këto data. Megjithatë, në shumicën e rasteve, datat e përfundimit janë identike për kontrata të ndryshme, gjë që ngre dyshime për mundësi manipulimi, pasi nuk përputhen me kontratat dhe referencat përkatëse.

Pretendimi nr. 3: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate eshte i pa pergjegjshem ne kriterin 9.1 dhe 9.2 te Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2. ku nuk ka ofruar deshmi per stafin profesional” dhe ate si vijon:2.OE-ik duhet te ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon - Nje Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë apo bachelor (drejtimi konstruktiv)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.2. Deshmia: CV, diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon një inxhinier ndërtimtarie – drejtimi konstruktiv, z. Ermal Hoxha, i cili është paraqitur në ofertë së bashku me dokumentacionin përkatës: autorizimin (me numër personal dhe datën e lindjes), kontratën, diplomën, CV-në, projektet dhe referencat e realizuara, në përputhje me kërkesat e FDT-se.- Nje Inxhinier i dip. i elektroteknikes apo bachelor (drejtimi elektroenergjetik)– min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit.Deshmia: CV, diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon një inxhinier të elektroteknikës – drejtimi elektroenergjetik, z. Bujar Gjocaj, i cili është paraqitur në ofertë së bashku me dokumentacionin përkatës: autorizimin (me numër personal dhe datën e lindjes), kontratën, diplomën, CV-në, projektet dhe referencat e realizuara, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në FDT.

- Nje Inxhinier i dip. i arkitektures apo ndertimtarise (konstruktiv) min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Deshmia: CV, diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete projekt

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon një inxhinier të ndërtimtarisë dhe arkitekturës, z. Shkëlqim Osmani, i cili është paraqitur në ofertë së bashku me dokumentacionin përkatës: autorizimin (me numër personal dhe datën e lindjes), kontratën, diplomën, CV-në, projektet dhe referencat e realizuara, në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT.- Një ekspert te certifikuar nga AME për mbrojtje nga zjarri me se paku 3 vjet pervoj pune nga certifikimi.- kopje te certifikates sipas kerkeses Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë posedon certifikatën për mbrojtje nga zjarri për z. Muhamet Hamiti, i cili është përfshirë në ofertë së bashku me dokumentacionin përkatës: kontratën, diplomën, CV-në, projektet si dhe certifikatat e tjera (përfshirë ISO), në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT.- Dy saldues te certifikuar.- kopje te certifikates apo diplome per salduesit Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të pabazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë posedon dy saldues, z. Nexhat Maxhuni dhe z. Jasmin Sliji, për të cilët janë bashkangjitur certifikatat dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me kriteret e përcaktuara në FDT.

Pretendimi nr. 4: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate se kontratat e ofruara te puntoreve figurojne me page qe nuk mund te kalojne pagen minimale.dhe jane ne kundërshtim me ligjin e punes me nr 03/L-212 i Plotsuar dhe I Ndryshuar me ligjin 08/L-117, asnje kontrate e puntoreve nuk e ploteso kete kusht”. AK ne FDT ka kerkuar:- 10 punetor tjere.- Kontrate per marrdhenje pune apo marrveshje per angazhim ne pune

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si pjesëshëm të bazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkëngjitur listën me 13 punëtorë që përmbush këtë kriter. Megjithatë, OE ankues pretendon se në kontratat e punëtorëve të OE të rekomanduar janë paraqitur paga në vlerë prej 180 dhe 200 eurosh, të cilat konsiderohen në kundërshtim me Ligjin e Punës. Kjo çështje mbetet në diskrecionin e Autoritetit Kontraktues dhe Operatori Ekonomik duhet të respektojë pagat në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës me Nr. 03/L-212 i Plotsuar dhe I Ndryshuar me ligjin 08/L-117.

Pretendimi nr. 5: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate nuk ka ofruar autorizime sipas kriterit te FDT-se dhe autorizimet qe ka ofruar jane gjenrale qe nuk lidhen me piken 9.12.13 qe don te thote nuk e permbushin kete kriter”, AK ne kriterin e poshtshenuar ka kerkuar: 3. Operatori ekonomike duhet te dorëzoj autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13) 3. Autorizimin nga prodhuesi ose dileri (distributori i autorizuar) për pozicionet (9,12,13)

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si pjesëshëm të bazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë posedon autorizime nga kompanitë GAMMASPORT dhe ITE-Kosova, të cilat e autorizojnë kompaninë AGE Group sh.p.k. në përgjithësi. Megjithatë, këto autorizime nuk përfshijnë pozicionet 9, 12 dhe 13, siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Për mendimin e ekspertit, OE i rekomanduar ka ngarkuar autorizime të përgjithshme në lidhje me projekt.

Pretendimi nr. 6: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomadur per kontrate ka ofruar kataloge te pergjithshme e jo sipas kriterit AK-se te kerkuar” si me poshte: 4. Operatori ekonomik duhet te dorëzoj katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)4. Katalogun nga prodhuesi me specifikat e kerkuara për pozicionet e paramasës (9,12,13)

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar katalogje të veçanta, siç ka kërkuar Autoriteti Kontraktues, por ka paraqitur vetëm katalogje të përgjithshme – bllanko, vetëm për të plotësuar kriterin në fjalë.

Pretendimi nr. 6: “Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i rekomadur per kontrate nuk ka plotsuar kete kriter sipas dosjes se tenderit ne te cilen ka ofruar librezea te automjeteve qe jane pa validitet dhe nuk permbushin kete kriter”, AK ne FDT ka kerkuar si me poshte:

5. Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit. Paisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 7 te DT.

5. Një listë te pajisjeve, sipas Aneksin 7, Librezat e qarkullimit per automjetet qe regjistrohen, Deklaratat unike doganore ose kontrata, fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marveshje per shfrytezimin, OE duhet te dorezoj edhe marveshjen per shfrytezim te marrjes me qira.

Eksperti shqyrtues e analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kriterin në fjalë. Së pari, marrëveshjet e paraqitura janë me data më të hershme se 24.03.2025 dhe me numra të tjerë të procedurave të prokurimit që nuk kanë lidhje me aktivitetin aktual të prokurimit. Gjithashtu, kamioni Mercedes Benz me vinc me dy dyer, sipas librezës, figuron me afat të skaduar të vlefshmërisë që ka përfunduar më 15.04.2025, çka bie në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në FDT-se.

Për më tepër, kamioni me korpe Renault Master nuk është i regjistruar në Republikën e Kosovës dhe figuron me targa të huaja, të shtetit francez (FS-647-YE). Për këtë automjet është bashkëngjitur një polisë sigurimi me vlefshmëri nga data 07.12.2023 deri më 07.01.2024, që do të thotë se nuk ka sigurim të rregullt për periudhën e realizimit të projektit, siç kërkohet nga Autoriteti Kontraktues në FDT).

Pretendimi nr. 7: “Operatori ekonomik ankues konsideron qe eshte i pergjegjgjishem dhe ploteson kriteriet e ANEKSIT 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME.

Eksperti shqyrtues pas verifikimit te pozicioneve analizon dhe e vlerëson këtë pretendim ankimor si të bazuar, me arsyetimin se në dokumentacionin teknik të paramasës, pozicioni 12 kërkon furnizimin e trupit ndriçues të llambës halide metalike me ndezës kuarc, me karakteristika të detajuara teknike si: fuqia e dritës 210000 lm, efikasiteti 110 lm/W, jetëgjatësia 6000 orë pune, rezistencë ndaj temperaturave të ndryshme, përputhje me standardet IEC/EN 60061-1, garanci 5 vite dhe origjinë evropiane, ndër të tjera.

Ndërkohë, pozicioni 13 specifikon furnizimin me droselin magnetik 2000W, 10.3A, 400V, i nevojshëm për funksionimin e llambës në pozicionin 12. Ky fakt tregon qartë se trupi ndriçues dhe droseli janë dy elementë të veçantë dhe të ndarë fizikisht, të cilët duhet të furnizohen dhe

ofrohen veç e veç.

Në analizën teknike dhe në bazë të dokumentacionit, rezulton se:

Paramasa nuk përfshin dhe nuk kërkon shtepenë ose kutinë montuese të trupit ndriçues si pjesë të detyrueshme për pozicionin 12.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të ofrojnë vetëm elementët e specifikuar në paramasë.

Mosdorëzimi i shtepzës montuese nuk mund të konsiderohet si mospërputhje teknike dhe nuk mund të jetë shkak për refuzimin e ofertës.

Për funksionimin e plotë të sistemit ndriçues, lidhja e trupit ndriçues me droselin është thelbësore dhe kjo lidhje kërkon elementë ndihmës si kabllloja lidhëse, por këto nuk janë pjesë e kërkesave të tenderit.

Në përfundim, oferta që përmban trupin ndriçues (pozicioni 12) dhe droselin (pozicioni 13) në mënyrë të ndarë dhe sipas kërkesave të paramasës është në përputhje të plotë me dokumentacionin teknik.

Pra, duke u bazuar në këtë analizë, mund të konkludojmë se:

Operatorët kanë dorëzuar në mënyrë korrekte dhe të plotë kërkesat për pozicionet 12 dhe 13.

Mospërfshirja e shtepzës montuese, e cila nuk është kërkuar në paramasë, nuk mund të shërbejë si argument për refuzim.

Oferta duhet të pranohet për këto pozicione, pasi përmbush të gjitha kërkesat teknike dhe specifikimet e tenderit.

Ky arsyetim është në përputhje me praktikën e zakonshme të tenderëve dhe standardet evropiane për furnizimin dhe instalimin e pajisjeve ndriçuese.

PROVE: Paramasa e plotësuar nga OE ankues:

Eksperti shqyrtues rekomandon Autoritetin Kontraktues që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlerësim, pasi Komisioni i Vlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me legjislacionin e Ligjit për Prokurimin Publik. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e FDT-se, prandaj kërkohet që edhe njëher të kryhet vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave në përputhje të plot me nenet 7 dhe 59 të LPP-së.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të gjithë dokumentacionit në platformën e eprokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i caktuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, ku kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të

pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/saj, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues si dhe nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi. Paneli Shqyrtues pajtohet me të gjeturat e ekspertit shqyrtues sipas të cilave tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që në raportin e ekspertit është argumentuar në mënyrë të matshme dhe të ligjshme se tenderuesi i rekomanduar nuk i ka përmbushur kërkesat përkatëse të dosjes së tenderit.

Megjithatë eksperti shqyrtues nuk ka ofruar aspak përgjigje bindëse në lidhje me arsyet sipas të cilave AK e ka eliminuar OE ankues nga aktiviteti i prokurimit. Në asnjë pikë eksperti shqyrtues nuk argumenton që OE ankues e ka dorëzuar mostrën të cilën AK ka gjetur se nuk është dorëzuar. Njëkohësisht edhe vet OE ankues në ankesën e tij vetëm pretendon se e ka përmbushur këtë kërkesë të DT mirëpo nuk prezanton argumente konkrete për të demantuar konstatimin e AK sipas të cilit nuk është dorëzuar mostra e sipas kërkesave të DT. Për këto arsye Paneli Shqyrtues i ka falur besimin autoritetit kontraktues përkatësisht arsyeve sipas të cilave OE ankues është eliminuar si ofertues i papërgjegjshëm nga ky aktivitet i prokurimit.

Rrjedhimisht është gjetur se jo vetëm tenderuesi i rekomanduar por edhe OE ankues kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme pasi që nuk kanë plotësuar të gjitha kërkesat e DT. Ngjashëm vlen edhe për tenderuesin e tretë në këtë aktivitet GOE “Alko-Impex General Construction shpk & Mardem Group shpk”, të cilët po ashtu janë eliminuar nga AK dhe GOE nuk ka kundërshtuar fare arsyet eliminuese që nënkupton se ky tenderues në këtë fazë nuk është fare palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Prandaj Paneli Shqyrtues nuk pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim pasi që të gjithë tenderuesit kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet pjesërisht si e bazuar ndërsa në kuptim të nenit 62 të LPP lidhur me nenin 43 të RRPP, aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet në tërësi në mungesë të ofertave të papërgjegjshme.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N.T.SH. " AR - DRITI "**
- Arkivës së OSHP-së: